

Nr. 7	PAA141.Q2.O1.A1. Mbështetje për funksionimin e organeve të zgjedhura vendore (Këshillit Bashkiak) shpenzime korente dhe kapitale	Funksioni 1: Shërbime të Përgjithshme Publike N/Funksioni 011: Organet ekzekutive dhe legjislativë, përçështjet financiare dhe fiskale, çështjet e brendshme. Programi AA141 Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse.
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
Në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Këshilli Bashkiak përbëhet nga 51 këshilltarë të zgjedhur, sipas dispozitave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë. Këshilli Bashkiak ka disa detyra dhe kompetenca: - zgjedh nga përbërja e vet komisionet e këshillit dhe miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të vet; - zgjedh, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, kryetarin dhe zëvendëskryetarët e këshillit dhe i shkarkon ata; - emëron dhe shkarkon sekretarin e Këshillit Bashkiak; - miraton nivelin e pagave e të shpërblimeve të punonjësve e të personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi; - miraton aktet e themelimit të ndërmarrjeve, shoqërive tregtare, si dhe të personave të tjerë juridikë që krijojnë vetë ose me të cilët është bashkëthemelues; - miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij. Në vendimin për miratimin e buxhetit miraton, gjithashtu, edhe numrin e maksimal të punonjësve të Bashkisë, si dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të Bashkisë; - miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve; - organizon dhe mbikëqyr kontrollin e brendshëm të Bashkisë; - vendos për fillimin e procedurave gjyqësore për çështje të kompetencës së vet; - zgjedh përfaqësuesit e Këshillit Bashkiak në Këshillin e Qarkut, të cilët, në jo më pak se 50 për qind të tyre, duhet t'i përkasin gjinisë më pak të përfaqësuar; - vendos për dhënien ose deklarimin e mbarimit të mandatit të këshilltarit, kur ekzistojnë kushtet e parashikuara në nenin 49 të këtij ligji; - miraton norma e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj; - vendos për simbolet e Bashkisë; - vendos për emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë; - jep tituj nderi dhe stimuj; - vendos për rregullat, procedurat dhe mënyrat e realizimit të funksioneve të deleguara, në bazë dhe për zbatim të ligjit, me të cilin bëhet ky delegim të Bashkia. Për mbështetjen e funksionimit të organeve të zgjedhura vendore ku përfshihen Këshilli i Bashkisë Shkodër me 51 anëtarë, zbatohet VKM nr. 328 dt. 31.05.2023 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore" i cili rregullon efektet e masës së shpërblimit për anëtarët e Këshillit të Bashkisë Shkodër. Shpërblimi i anëtarëve të këshillit kryhet në formën e shpërblimit (honorareve), në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Për mbulimin e shpenzimeve të këshilltarëve bashkiakë gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre si këshilltarë për trajtim financiar për shërbim jashtë dhe brenda vendi, Këshilli do të miratojë me vendim mënyrën se si do të veprojë. Të gjitha shpenzimet për funksionimin, mbarëvajtjen dhe zhvillimin e veprimtarisë së Këshillit Bashkiak që nuk janë të përfshira në këtë fishe projekti mbulohen buxheti i Bashkisë. Plani i aktiviteteve të Këshillit Bashkia është bashkangjitur me këtë fishe project.		
ii. Synimi i projektit		
- Mbështetja e funksionimit të Këshillit i Bashkisë Shkodër - Sigurimi i mbështetjes me shërbime operative për funksionimin e Këshillit Bashkiak sipas aktiviteteve - Garantimi i masës së shpërblimit në përputhje me aktet ligjore në fuqi. - Përmirësimi i kanaleve të komunikimit me qytetarët, rritja e përfshirjes së tyre në vendimmarrje dhe në të njëjtën kohë matja punës dhe kryerjes së detyrave dhe funksioneve të Këshillit Bashkiak. - Sigurimi i mbështetjes me shërbimeve operative për funksionimin e Këshillit Bashkiak për aktivitetet: - Dërgim me postë të dokumenteve, shkresave të këshillit dhe këshilltareve - Kancelari - Transport - Shpenzime catering /coffee break - Shpenzime pritje percejllje - Realizimi i shpërblimit mujor për anëtarët e Këshillit Bashkiak të Bashkisë Shkodër sistematikisht dhe me korrektësi për çdo muaj.		
b) Rezultatet që prisni		

- Funksionimi sipas ligjit i Bashkise Shkoder si rezultat i miratimit ne kohe te te gjithë akteve te paraqitura ne mbledhjet e Këshillit Bashkiak.
- Miratimi i raportit për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave/ Ardhurave dhe shpenzimeve
- Komuniteti i informuar si rezultat i transparences dhe llogaridhenies per veprimtarinë së Këshillit Bashkiak/
- Keshilli Bashkiak aktiv dhe pjesëmarrjes në aktivitete te rendesishme vendore, konferenca, dhe aktivitete me interes për KB
- Raporti i vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve i miratuar.
- Tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel te shqyrtuara dhe te miratuara
- Shërbimit i Pastrimit / Transportit / Ndrimit / Shërbimeve sociale / Arsimit baze dhe parashkollor/ Investimeve publike te monitoruara dhe te permiresuara;
- Ndërmarrja Ujësjellës/Kanalizime te analizuar/monitoruar.
- Aftesite e Sekretariatit e KB dhe keshilltareve te rritura dhe te permiresuara.
- Komuniteti dhe transparenca e veprimtarisë së Këshillit te permiresuara-Procudurat e Ankesave, Kerkesave, Peticioneve dhe Nismave Qytetare te promovuara.
- Forumi e Shoqerise Civile dhe Rinise i informuar per punen e keshillit; Promovimi i Peticioneve dhe Iniciativave qytetare kryer.
- Komuniteti i konsultuar per Sherbimet e pastrimit, per Sherbimin te Pastrimit, te transportit , Ndrimit, te Sherbimeve sociale, te Arsimit baze dhe parashkollor.
- Buxheti vjetor dhe PBA te miratuar/ Paketa fiskale e miratuar/ Prioriteve e investimeve ne bashki te miratuar.
- Komuniteti i Bashkise Shkoder i mireinformuar per buxhetin e Bashkise dhe aktivitetin e Keshillit Bashkiak ne media vendore dhe online.
- Përmirësim i komunikimit me qytetarë, rritja e përfshirjes së tyre në vendimmarrje dhe matja e performances së kryerjes së detyrave dhe funksioneve të Këshillit Bashkiak.

c) Aktorët e mundshëm	d) Kontributet e mundshme në projekt
• Komisioni i financave, buxhetit, dhe aseteve publike • Sekretari i Keshillit Bashkiak • Të gjitha drejtoritë e Bashkisë • Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse • Drejtoria e Financës • Institucioni që ndjek shpenzimet: Bashkia Qendër	Bashkia e Shkodrës

e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijëlekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shpërblim Anëtarë Këshilli Bashkiak 10% e pagës së Kryetarit (51 anëtarë)	17,748			17,748		
A.2	Blerje kancelari, letër, bojë printeri dhe fotokopje	193			193		
A.3	Blerje paisje të ndryshme zyre	15					15
A.4	Blerje paisje TIK	275					275
A.5	Shpenzime për aktivitete përfaqësues të Këshilltarëve (dieta –pritje percejelle)	500			500		
A.6	Vizitë studimore për Këshilltarët	1,000			1,000		
A.7	Udhëtime e dieta (trajnime)	600			600		
A.8	Shpenzime për dhurata ceremoniale dhe tituj nderi	100			100		
A.9	Ekspertize per Këshillin (Në varësi të P-Vendimeve të paraqitura ne Këshill nga Bashkia)	100			100		
	Shuma	20,531			20,241		290
Shpenzimet për çdo aktivitet 2026		Totali (mijëlekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shpërblim Anëtarë Këshilli Bashkiak 10% e pagës së Kryetarit (51 anëtarë)	17,748			17,748		
A.2	Blerje kancelari, letër, bojë printeri dhe fotokopje	193			193		
A.3	Blerje paisje të ndryshme zyre	15					15
A.4	Blerje paisje TIK	75					75

A.5	Shpenzime për aktivitete përfaqësues të Këshilltarëve (dieta –pritje percjellje)	500			500		
A.6	Vizitë studimore për Këshilltarët	1,000			1,000		
A.7	Udhëtime e dieta (trajnime)	600			600		
A.8	Shpenzime për dhurata ceremoniale dhe tituj nderi	100			100		
A.9	Ekspertize per Këshillin (Në varësi të P-Vendimeve të paraqitura ne Këshill nga Bashkia)	100			100		
	Shuma	20,331			20,241		90
Shpenzimet për çdo aktivitet 2027		Totali (mijëlekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shpërblim Anëtarë Këshilli Bashkiak 10% e pagës së Kryetarit (51 anëtarë)	17,748			17,748		
A.2	Blerje kancelari, letër, bojë printeri dhe fotokopje	193			193		
A.3	Blerje paisje të ndryshme zyre	15					15
A.4	Blerje paisje TIK	75					75
A.5	Shpenzime për aktivitete përfaqësues të Këshilltarëve (dieta –pritje percjellje)	500			500		
A.6	Vizitë studimore për Këshilltarët	1,000			1,000		
A.7	Udhëtime e dieta (trajnime)	600			100		
A.8	Shpenzime për dhurata ceremoniale dhe tituj nderi	100			100		
A.9	Ekspertize per Këshillin (Në varësi të P-Vendimeve të paraqitura ne Këshill nga Bashkia)	100			100		
	Shuma	20,331			20,241		90
f) Periudha e zbatimit Janar 2025– Dhjetor 2027		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Financës Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					

Plani i punës dhe aktiviteteve - Këshilli Bashkiak Shkodër 2025	
Muaji	Përshkrimi i Aktivitetit
Janar	Mbledhje e Këshillit (Plenare)
	Mbledhjet e Komisioneve te Perhershme te Keshillit Bashkiak
	Pjesëmarrje ne konferenca e aktivitete të ngjashme
Shkurt	Mbledhje e Këshillit (Plenare)
	Mbledhjet e Komisioneve te Perhershme te Keshillit Bashkiak
	Konsultime me komunitetin per ceshtje qe sipas ligjit kane nevojë per konsultim, norma e standarte te sherbimeve publike dhe fukioneve te tjera ligjore (ne varesi te projektvendimeve te paraqitura ne Këshill nga Bashkia)
	Pjesëmarrje ne konferenca e aktivitete të ngjashme
Mars	Mbledhje e Këshillit (Plenare)
	Mbledhjet e Komisioneve të Përhershme të Këshillit Bashkiak
	Hartimi i raportit të veprimtarisë vjetore të Këshillit
	Hartimi dhe prezantimi i raportit vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes së Këshillit (ligji 146/2014, neni 20)

Prill	Mbledhje e Këshillit (Plenare)
	Mbledhjet e Komisioneve të Përhershme të Këshillit Bashkiak
	Konsultime me komunitetin për çështje të Draft PBA, ndryshim buxheti, norma e standarte të shërbimeve publike dhe funksioneve të tjera ligjore. (në varesi të projektvendimeve të paraqitura në keshill nga Bashkia)
Maj	Mbledhje e Këshillit (Plenare)
	Mbledhjet e Komisioneve të Përhershme të Këshillit Bashkiak
	Ceremoni dhenie titull nderi
	Pjesëmarrje në konferenca e aktivitete të ngjashme
	Pritje e delegacionit nga keshilla homologe
Qershor	Mbledhje e Këshillit (Plenare)
	Mbledhjet e Komisioneve të Përhershme të Këshillit Bashkiak
	Vizite studimore
	Pjesëmarrje në konferenca e aktivitete të ngjashme
Korrik	Mbledhje e Këshillit - (Plenare)
	Mbledhjet e Komisioneve të Përhershme të Këshillit Bashkiak
	Emision në median vendore dhe online
	Perfaqësim institucional i Këshillit: (në Shoqatat perkatese)
	Rishikim i Buxhetit vjetor
Gusht	Mbledhje e Këshillit (Plenare)
	Mbledhjet e Komisioneve të Përhershme të Këshillit Bashkiak
	Konsultime me komunitetin për çështje që sipas ligjit kanë nevojë për konsultim, norma e standarte të shërbimeve publike dhe funksioneve të tjera ligjore, (në varesi të projektvendimeve të paraqitura në Këshill nga Bashkia)
Shtator	Mbledhje e Këshillit (Plenare)
	Mbledhjet e Komisioneve të Përhershme të Këshillit Bashkiak
	Konsultime me komunitetin për çështje që sipas ligjit kanë nevojë për konsultim, norma e standarte të shërbimeve publike dhe funksioneve të tjera ligjore, Strategji e Plane (në varesi të projektvendimeve të paraqitura në Këshill nga Bashkia); Konsultime me komunitetin për çështjen e: buxhetit apo ndryshim buxheti, pakete fiskale apo ndryshime, (në nr.5 gjithsej i konsultimeve : nr.4 i konsultimeve në NJA, nr.1 i konsultimeve me grupe interesi)
	Draftimi i planit vjetor i vendimarrjes së Këshillit
	Draftimi i planit të trajnimit për këshilltarët
	Hartimi i buxhetit të Këshillit Bashkiak për vitin
Tetor	Mbledhje e Këshillit (Plenare)
	Mbledhjet e Komisioneve të Përhershme të Këshillit Bashkiak
	Konsultime me komunitetin për çështjen e: buxheti apo ndryshim buxheti, pakete fiskale apo ndryshim, (në nr. 5 gjithsej i konsultimeve: nr. 4 i konsultimeve në NJA, nr.1 i konsultimeve me grupe interesi)
	Ceremoni dhenie titull nderi
	Pjesëmarrje në konferenca e aktivitete të ngjashme
	Pritje e delegacionit nga keshilla homologe
	Perfaqësim institucional i Këshillit në Shoqata, Këshill Konsultativ, etj. Diskutime për rolin e keshillit bashkiak në institucionet e perfaqësimit
Nëntor	Mbledhje e Këshillit (Plenare)
	Mbledhjet e Komisioneve të Përhershme të Këshillit Bashkiak
	Konsultime me komunitetin për çështje që sipas ligjit kanë nevojë për konsultim, norma e standarte të shërbimeve publike dhe funksioneve të tjera ligjore, Strategji e Plane (në nr. 1 gjithsej i konsultimeve: nr.1 i konsultimeve me grupe interesi - në varesi të projektvendimeve të paraqitura në Këshill nga Bashkia)
	Ceremoni dhënie titull nderi

	Pjesëmarrje ne konferenca e aktivite të ngjashme
Dhjetor	Mbledhje e Këshillit (Plenare)
	Mbledhjet e Komisioneve të Përhershme të Këshillit Bashkiak
	Pjesëmarrje ne konferenca e aktivite të ngjashme
	Emission në median vendore dhe online